



IOM International Organization for Migration
ONM Organizata Ndërkombëtare për Migracionin

PAKETË INFORMUESE PËR HOLANDËN

1. Informacioni bazë

a) Kryeqyteti:	Amsterdam
b) Popullsia:	16,360,000
c) Sipërfaqja:	41,864m ²
d) Monedha:	Euro (EUR)
e) Niveli i papunësisë:	2.7%

2. Kushtet e përgjithshme të hyrjes dhe informacioni për vizë

Një i huaj që hyn në Holandë duhet të ketë një dokument të vlefshëm udhëtimi si dhe vizë ose leje qëndrimi.

Kush nuk ka nevojë për vizë?

Shtetasit e vendeve të BE-së/ZEE dhe shtetasit e vendeve të treta me të cilët Holanda ka një regjim pa viza nuk kanë nevojë për vizë që të hyjnë në Holandë. Ata mund të qëndrojnë në vend për jo më shumë se 90 ditë në një periudhë gjashtë mujore duke filluar nga dita e parës e hyrjes.

Llojet e vizave

Autoritetet holandeze mund të lëshojnë katër lloje vizash. Lloji i vizës tregohet në vizën pullë në një seksion të veçantë dhe të shënuar me shkronjat A, B, C, ose D.

Vizë transiti në aeroport- A

Kjo vizë mundëson që të huajt të cilëve u kërkohet vizë të qëndrojnë në zonën ndërkombëtare të transitit në aeroporti ndërsa presin fluturimin tjetër, por nuk u lejon hyrjen në vend. Shtetasit e Shqipërisë, Bosnjë dhe Hercegovinës, Kroacisë, ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë, Malit të Zi dhe Serbisë nuk kanë nevojë për vizë transiti në aeroport (A).

Vizë transit- B

Kjo vizë i jep të drejtën një të huaji që udhëton nga një vend në tjetrin të kalojë transitin nëpërmjet territorit të Shengenit. Një vizë transit mund të nxirret vetëm nëse i huaji provon që ai ose ajo lejohet të hyjë në vendin tjetër.

[Kjo paketë informuese u përgatit në kuadër të projektit AENEAS 2006: Ndërtimi i Kapaciteteve, Informacion dhe Ndërgjegjësim për Promovimin e Migracionit të Rregullt në Ballkanin Perëndimor të financuar nga Bashkimi Europian dhe të bashkë-financuar nga Zyra Federale Zvicerane për Migracionin, Zyra Federale Gjermane për Migracionin dhe Refugjatët, Ministria Italiane e Punëve të Jashtme/Bashkëpunimi Italian për Zhvillim dhe Qeveria e Lihtenshtejn.](#)



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra



Federal Office
for Migration
and Refugees



të destinacionit pas qëndrimit të tij ose të saj në territorin e Shengenit. Një vizë transit mund të jepet për të kaluar një ose dy herë transit dhe, në raste të veçanta, për të kaluar shumë herë transit, me kushtin që asnjë kalim transit nëpërmjet vendit të mos kalojë numrin e ditëve të përcaktuara në kohëzgjatjen e seksionit të qëndrimit të vizës pullë. Vizat transit me ligj nuk mund të kalojnë 5 ditë.

Vizë afatshkurtër- C

Kjo vizë i jep të drejtën një të huaji të hyjë dhe të qëndrojë në territorin Shengen për turizëm, biznes, vizita personale apo qëllime të tjera për hyrje. Një vizë afat-shkurtër mund të jepet për një, dy ose më shumë hyrje në vendin ku as një qëndrim i vetëm i pandërprerë, as kohëzgjatja e plotë e numrit të qëndrimeve të njëpasnjëshme nuk i kalon 90 ditë brenda një periudhe gjashtë mujore, duke filluar nga dita e hyrjes së parë.

Bazuar në Marrëveshjet për Lehtësimin e Vizave dhe në Marrëveshjet e Ri-pranimit ndërmjet BE-së dhe **Shqipërisë, Bosnjë Hercegovinës, ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë, Malit të Zi dhe Serbisë**, shtetasit e këtyre vendeve duhet të kërkojnë vizë C Shengen për të hyrë në Holandë; megjithatë ata përfitojnë një tarifë të reduktuar vize (35 Euro në vend të 60 Euro). Shumë kategori të aplikantëve (familjarë të shtetasve rezidentë të ligjshëm, studentë dhe pensionistë, gazetarë etj) tani mund të marrin gjithashtu viza falas. Për kategori të caktuara personash p.sh. tregtarë, studentë dhe gazetarë, kërkesat për dokumentacion do të thjeshtohen. Disa kategorive të personave që udhëtojnë shpesh (përfshirë këtu tregtarë, gazetarë, studentë, përfaqësuesi të shoqërisë civile) do t'u jepen viza me shumë hyrje për periudha të gjata vlefshmërie dhe mbajtësit e pasaportave diplomatike do të përjashtohen nga detyrimi për vizë.

Shihni hollësi në:

<http://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=OJ:L:2007:334:0085:0095:EN:PDF> (për Shqipërinë)
<http://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=OJ:L:2007:334:0097:0107:EN:PDF> (për Bosnjë dhe Hercegovinën)
<http://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=OJ:L:2007:334:0125:0135:EN:PDF> për ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë
<http://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=OJ:L:2007:334:0137:0147:EN:PDF> për Serbinë
<http://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=OJ:L:2007:334:0109:0119:EN:PDF> për Malin e Zi

Vizë afatgjatë D

Për qëndrim më shumë se tre muaj:

Ju duhet një autorizim për qëndrim të përkohshëm (MVV). Një MVV është një pullë që vihet në pasaportën tuaj. Aplikoni për atë në ambasadën ose konsullatën holandeze në vendin tuaj të origjinës (ose vendin ku qëndroni në mënyrë të ligjshme). Është jashtëzakonisht e rëndësishme të keni këtë vizë përpara se të vini në Holandë.

Mund të filloni procedurën për autorizim për qëndrim të përkohshëm (MVV) në dy mënyra të ndryshme:

- një sponsor në Holandë fillon procedurën MVV me anë të një kërkesë për këshillim në Departamentin e Imigracionit dhe Natyralizimit (IND)
- Ju aplikoni për MVV në vendin tuaj të origjinës. Kjo bëhet në ambasadën ose konsullatën holandeze.

Qëllimi i kërkesës për këshillim nga sponsori është të mbështesë aplikimin e MVV që do të dorëzoni më pas në Ambasadë. Vendimi në përgjigje të kësaj kërkesë për këshillë është vetëm këshillë pozitive ose negative. Nuk mund të dorëzoni një aplikim për rishikim.

Aplikimi që dorëzoni në ambasadë është aplikim zyrtar. Mund të paraqisni një aplikim për rishikim të një vendimi negativ. Për më shumë informacion, shihni faqen e internetit: www.ind.nl

Ku të aplikoj?

Lista e misionëve diplomatike dhe postave konsullore holandeze ku mund të dorëzoni aplikimin për vizë:

http://www.mfa.nl/en/navigation_left/websites_of_foreign

Megjithatë nëse keni viza Shengen, duhet të merrni disa dokumente të rëndësishme.

Kur udhëtoni në zonën Shengen, sigurohuni që të merrni me vete kopje të të gjitha dokumenteve dhe të gjitha vërtetimeve që duhet të dorëzoni për të marrë një vizë.

Sidomos:

Dokumente dhe vërtetime të tjera në lidhje me burimet tuaja financiare:

- monedhë te konvertueshme, çek udhëtimi, librezë kursimi dhe/ose
- (nëse aplikohet) një kopje të letrës së legalizuar të garancisë që paraqitet me aplikimin për vizë,
- fotokopje të vërtetimit të të ardhurave të garantit dhe sigurimit shëndetësor të udhëtitimit

Dokumente dhe vërtetime të tjera për të konfirmuar qëllimin e vizitës tuaj:

- nëse synoni të vizitoni miq ose të afërm, një kopje të ftesës së legalizuar;
- nëse synoni të qëndroni në një hotel, një rezervim në hotel ose vërtetim që e keni parapaguar faturën;
- nëse synoni të bëni vizitë për biznes, dokumente që tregojnë natyrën e biznesit tuaj (kuotime, fatura, kontrata, etj)
- nëse synoni të bëni trajtim mjekësor, dokumente që tregojnë se synoni të vizitoni Holandën për arsye mjekësore (një letër nga spitali ku do të trajtoheni, vërtetim që jeni i siguar nga ana shëndetësore, vërtetim që keni paguar për trajtimin, ose vërtetim që mund të përballoni trajtimin);
- nëse jeni artist që synon të paraqitet në Holandë, një leje të vlefshme pune (nëse kërkohet) dhe dokumente që përcaktojnë vendin, kohën dhe kohëzgjatjen e saktë të performancës tuaj

3. Imigracioni për qëllime punësimi

a) Kushtet e hyrjes dhe qëndrimit të punëtorëve të huaj (duke përfshirë lloje të lejeve të punës dhe vizat dhe kërkesat e punës dhe autoritetet përgjegjëse)

Holanda ka një ekonomi të begatë dhe të hapur që varet shumë nga tregtia e jashtme. Ekonomia dallohet për marrëdhënie të qëndrueshme industriale, papunësi dhe inflacion të ulët, tepricë të llogarisë rrjedhëse të matshme, dhe një rol të rëndësishëm si qendra europiane e transportimit. Veprimtaria industriale është kryesisht në përpunimin e ushqimit, lëndëve kimike, rafineritë e naftës dhe makineritë elektrike. Një sektor bujqësor tepër i mekanizuar përdor jo më shumë se 2% të forcës së punës, por siguron teprica të mëdha për industrinë e përpunimit të ushqimit dhe për eksportet.

Nëse një shtetas i huaj dëshiron të punojë në Holandë, në disa raste punëdhënësi i tij do të duhet të aplikojë për leje. Kjo është leje pune. Leja nxirret nga Qendra për Punë dhe të Ardhura (CWI). Punëdhënësit do t'i jepet kjo leje nëse askush tjetër nuk është në dispozicion për pozicionin në Holandë ose në BE (me disa përjashtime).

Punëdhënësi duhet të aplikojë për leje pune dhe jo personi në fjalë. Kjo ndodh sepse punëdhënësit holandezë, kur plotësojnë vendet vakante, pritet që në fillim t'u japin një mundësi shtetasve holandezë ose të BE-së/ZEE. Ata duhet të vërtetojnë që e kanë provuar këtë gjë dhe kanë dështuar, përpara se të marrin një leje pune për dikë nga një vend që nuk ka përparësi.

Punëdhënësi duhet të aplikojë për leje pune në Qendrën për Punë dhe të Ardhura (CWI) në Zoetermeer. Punëdhënësi do të plotësojë formularin e duhur për ju. Disa prej dokumenteve të nevojshme do të sigurohen nga punëdhënësi juaj, të tjera do të duhet t'i siguron vetë.

Dokumentet e nevojshme për një leje pune:

- fotokopje e pasaportës tuaj,
- fotokopje e aplikimit tuaj për një vizë afatshkurtër, MVV (nëse kërkohet) ose leje qëndrimi
- diploma dhe certifikata,
- kopje e regjistrimit të punëdhënësit në Dhomën e Tregtisë,
- marrëveshja e punës ose plani i kërkimit,
- deklaratat e pagës mujore bruto,
- përshkrimi i punës,
- Paga mujore bruto

Për t'u pranuar për një leje pune, do të duhet të vërtetoni që do të fitoni një shumë minimale parash.

Kjo shumë minimale mujore që kërkohet varet nga statusi juaj:

- Lektorët: € 1264,80 (bruto, pagesa për pushime nuk përfshihet),
- Kërkues shkencorë:
 - që po bëjnë një Doktoraturë si një AIO/OIO: nga € 1813 bruto në vitin e parë deri në € 2283 bruto në vitin e katërt
 - që po bëjnë një Doktoraturë, por jo si AIO/OIO: € 1264,80 (bruto, pagesa për pushime nuk përfshihet)
 - që po bëjnë kërkim shkencor: € 1264,80 (bruto, pagesa për pushime nuk përfshihet)
 - që po bëjnë kërkim shkencor ndërkohë që ruajnë kontratën me punëdhënësin në vendin e origjinës: nuk kërkohet paga mujore bruto minimale
- Studentët që bëjnë praktikën ose vende pune: nuk kërkohet pagë mujore minimale bruto;
- Të diplomuarit që bëjnë stazhin pas përfundimit të diplomës: € 1264,80 (bruto, pagesa për pushime nuk përfshihet);
- Studentë që punojnë ndërkohë që studiojnë (ose punë sezonale me kohë të plotë në qershor, korrik dhe gusht, ose punë me kohë të pjesshme jo më shumë se dhjetë orë në javë): nuk kërkohet pagë mujore minimale bruto.

Dokumente shtesë që duhen për një stazh (vend pune):

- marrëveshja e stazhit,
- dokument nga institucioni arsimor i studentit që konfirmon që stazhi është pjesë e nevojshme e arsimit të studentit
- dokument nga institucioni pritës që vërteton që studentin është regjistruar atje.

Një leje punë mund të jetë e vlefshme për një periudhë deri në tre muaj. Pasi të keni marrë një leje pune për tre vjet, nuk do t'ju duhet tjetër. Një leje pune e përkohshme (e vlefshme për më pak se tre vjet) shpesh nuk mund të shtyhet, por punëdhënësi mund të kontaktojë CWI për më shumë informacion për këtë mundësi. Nëse keni pyetje për punën dhe të ardhurat në Holandë, shihni www.werk.nl

b) Sektorët e tregut të punës që kanë mangësi

Nevojat aktuale të Holandës janë për punëtorë migrantë në sektorin e kujdesit shëndetësor (sidomos për infermieri dhe ndihmë në shtëpi kujdesi)

c) Faqet e internetit për të kërkuar punë

www.werk.nl

www.eurobrussels.com

www.learn4good.com

www.careers.org

www.monsterboard.nl

www.jobbingmall.nl

www.jobnews.nl

www.vacaturebank.nl

www.agrojobs.nl: profesione akademike (në holandisht dhe anglisht)

www.academictransfer.nl: punë grafike

www.cadjobs.nl: punë arkitekturale (në holandisht me këshilla në anglisht)

www.archined.nl: punë në eksport, pjesërisht në anglisht

www.export.nl: transport dhe në det

www.medweb.nl: punë në shëndetësi

www.detaching.pagina.nl

www.werving-selectie.pagina.nl

www.mercuri-urval.com

www.birdengineering.nl: bioteknologji

www.fashionsolution.nl: veshje të gatshme dhe modë
www.ranger.nl: profesionistë me arsim të lartë
www.elanit.nl: IT&T
www.yachtgroup.com: menaxhim i ndërmjetëm

d) *au-pair* dhe programe të tjera specifike për punë për të huajt

Programi ndërkombëtar *Au Pair* www.easyaupair.com

4. Imigracioni për qëllime studimi

Arsimi në vështrim të shkurtër

Diplomat e para

- Universitete të arsimit profesional: diplomë universitare katër vjeçare
- Universitete klasike: diplomë universitare tre vjeçare

Mosha e diplomimit

21–23 vjeç

Diplomat më të larta

- Diplomë Master (një deri në dy vjet)
- Doktoraturë (katër vjet)
- Diplomë pasuniversitare

Pranueshmëria për diploma më të larta

- Diplomë pasuniversitare dhe diplomë Master: një diplomë universitare ose ekuivalente.
- Doktorature: një diplomë të mirë Master dhe aftësi kërkimi

Tarifat

- Parauniversitare: €1,476 - €5,000.
- Pasuniversitare: €1,476 - €5,000.

Arsimimi i lartë

Ka dy lloj arsimimesh të larta: arsimimi universitar, i ofruar në 47 universitete dhe arsimim i lartë profesional që ofrohet në 54 *hogescholen* (HBO).

Termi *hogescholen* (HBO) në anglisht përkthehet si "universitete të arsimit profesional". Që në shtator 2002, arsimimi i lartë holandez është ristrukturuar sipas Marrëveshjes së Bolonjës.

Spektori universitar

Të diplomuarit universitarë dikur fitonin titullin *doctorandus* (i shkurtuar si drs), *ingenieur* (inxhinier-i shkurtuar si ir) ose *meester* (mjeshtër- i shkurtuar si mr), sipas fushës së tyre të studimit.

Në një kontekst ndërkombëtar, legjislacioni holandez tashmë i ka lejuar këta të diplomuar të përdorin titullin më të njohur Master. Sipas Marrëveshjes së Bolonjës, të diplomuarit e universitetit Holandez tani diplomohen me diplomë universitare pas tre vjetësh. Diploma Master në Holandë më pas bëhet diplomë pasuniversitare, në vend të diplomës të parë që dikur ishte në Holandë.

Spektori jo universitar

Kurset HBO përgjithësisht janë më pak teorike dhe më shumë praktike sesa kurset universitare. Studentët HBO diplomohen pas katër vjetësh.

a) Kushtet e hyrjes dhe qëndrimit të studentëve (vizë studenti, leje qëndrimi, e drejta për punë nëse vlen)

Nëse doni të studioni në Holandë për më shumë se 3 muaj duhet të plotësoni kushtet dhe të keni dokumentet e mëposhtme:

- një pasaportë të vlefshme,
- sigurim shëndetësor që mbulohet në Holandë,
- vërtetim (paraprak) të regjistrimit në një institut arsimor holandez të njohur nga Ministria Holandeze e Arsimit
- duhet të firmosni një deklaratë që tregon se jeni të ndërgjegjshëm,
- nuk përbëni rrezik për rendin publik,
- jeni të përgatitur të bëni testin e tuberkulozit
- keni fonde të mjaftueshme

Kushte shtesë për arsim dytësor dhe profesional

Nëse doni të studioni në një institut për arsimin dytësor dhe profesional, kushtet e mëposhtme shtesë zbatohen gjithashtu:

- duhet të jetë arsimim me kohë të plotë gjatë ditës (jo kurs me korrespondencë ose mbrëmjeje)
- Holanda duhet të jetë vendi më i përshtatshëm për studimin tuaj të veçantë, studimet do të mundësojnë të bëni një kontribut pozitiv në vendin tuaj
- duhet të jetë një kurs arsimor sipas Aktit të Arsimit Dytësor

Çfarë dokumente ju nevojiten?

Nëse doni të vini në Holandë për qëllime studimi dhe të qëndroni më shumë se 3 muaj, do t'ju duhen disa dokumente. Duhet të siguronit disa nga këto dokumente në kohën e aplikimit për një autorizim për qëndrim të përkohshëm (MVV). Dokumentet e tjera do të nevojiten deri sa të hyni në Holandë.

Për të studiuar në Holandë do t'ju duhen:

- një pasaportë e vlefshme,
- vërtetim i sigurimeve shëndetësore,
- vërtetim i fondeve të mjaftueshme,
- një deklaratë e firmosur e formimit,
- një deklaratë e firmosur që jeni të ndërgjegjshëm,
- një regjistrim (paraprak) në një institucion arsimor holandez të njohur nga Ministria holandeze e arsimit
- Dy fotografi pasaporte me ngjyrë

Vetëm në rastin e arsimit dytësor ose profesional:

- Një shpjegim me shkrim për arsye pse Holanda është vendi i duhur për të ndjekur studimin dhe në çfarë kuptimi studimi është me vlerë reale për tregun e punësimit në vendin tuaj.

Autorizimi për qëndrim të përkohshëm

Do t'ju duhet autorizim për qëndrim të përkohshëm (MVV). Aplikoni për një MVV në vendin tuaj të origjinës. Më pas përdorni MVV të udhëtoni në Holandë. Sapo të keni arritur në Holandë, duhet së pari të paraqiteni në policinë për të huajt. Më pas aplikoni në bashki për një leje qëndrimi të përkohshëm.

Aplikimi për një autorizim për qëndrim të përkohshëm

Mund të filloni procedurën për autorizim për qëndrim të përkohshëm (MVV) në dy mënyra të ndryshme:

- një sponsor në Holandë fillon procedurën MVV me anë të një kërkesë për këshillim në Departamentin e Imigracionit dhe Natyralizimit (IND)
- Ju aplikoni për MVV në vendin tuaj të origjinës. Kjo bëhet në ambasadën ose konsullatën holandeze.

Qëllimi i kërkesës për këshillim nga sponsori është të mbështesë aplikimin e MVV që do të dorëzoni më pas në Ambasadë. Vendimi në përgjigje të kësaj kërkesë për këshillë është vetëm këshillë pozitive ose negative. Nuk mund të dorëzoni një aplikim për rishikim.

Aplikimi që dorëzoni në ambasadë është aplikim zyrtar. Mund të paraqisni një aplikim për rishikim të një vendimi negativ. Për më shumë informacion, shihni faqen e internetit: www.ind.nl

Leja e punës (tewerkstellingsvergunning, TWV) – për vizitorët akademikë

Për disa grupe të vizitorëve akademikë, lejet e punës janë të nevojshme:

- Lektorët (përjashtim: lektorët e ftuar që qëndrojnë për maksimumi 12 muaj)
- Kërkuesit shkencorë (përfshirë këtu studentët për doktoraturë);
- Studentë që bëjnë praktikën apo stazhin;
- Të diplomuar që bëjnë praktikë pas përfundimit të një diplome;
- Studentë që punojnë ndërkohë që studiojnë (ose punë sezonale me kohë të plotë në qershor, korrik dhe gusht, ose punë me kohë të pjesshme jo më shumë se dhjetë orë në javë)

Kategoritë e mëposhtme janë të përjashtuara nga lejet e punës:

- Kërkuesit shkencorë që bëjnë kërkimin në bazë të një fondi/burse nga BE, qeveria holandeze, universitetet holandez apo institut kërkimi;
- pjesëmarrësit e programeve të veprimit të BE-së si Leonardo da Vinci;
- lektorë të ftuar që qëndrojnë jo më shumë se 12 muaj.

b) Bursa universitare dhe pasuniversitare

Arsimi pasuniversitar

HBO holandeze (Hoger Beroeps Onderwijs, që tregon nivelin e Kolegjit ose "Universitetit të Arsimit Profesional"), të diplomuarit dhe të diplomuarit e huaj me diplomë të parë ekuivalente me një diplomë universitare që kërkojnë arsimim pasuniversitar në Holandë, mund të pranohen në program Master të rregullt në një universitet, por të dyja grupet duhet të plotësojnë në fillim kërkesat shtesë.

Përveç kësaj mënyrë, ka tre lloj studimesh pasuniversitare ku mund të pranohen të diplomuarit e huaj që kanë një diplomë ekuivalente me një universitet holandez ose HBO; programet profesionale, programet akademike dhe programet e doktoraturës.

Programe profesionale

Këto kurse janë në një nivel më të lartë sesa diploma universitare HBO që përfshin specializim të thellë në fushën ku është marrë diploma fillestare. Disa çojnë në diplomë Master. Këto kurse nuk merren zakonisht nga të diplomuarit në Universitete.

Programe akademike

Ka kurse që përfshijnë specializim në fusha të ndryshme. Për të diplomuarit e universiteteve holandeze, disa prej këtyre kurseve mund të çojnë në marrjen e një Masteri të nivelit të dytë.

Doktoratura

Titulli i Doktorit fitohet me anë të kryerjes së kërkimit origjinal nën udhëheqjen e drejtpërdrejtë të një profesori dhe më pas raportimit dhe diskutimit të rezultateve në një disertacion, që mund të marrë trajtën e një libri. Nuk kërkohet punë shtesë në kurs për disertacion.

Kandidati për doktor punon në mënyrë të pavarur dhe me kohë të plotë, zakonisht për një periudhë katër deri në pesë vjet. Studentë të huaj dhe holandezë mund të aplikojnë për një punë si *promovendus* në një universitet holandez (p.sh në shkenca).

Programet e doktoraturës të ashtuquajtura "të mësuara" në Holandë janë të rralla.

Shumë shpesh, një student i huaj i diplomuar mund të fitojë një doktoraturë duke përdorur modelin "sanduiç"; ai ose ajo përgatit një projekt kërkimi në universitet holandez, kryen punë në terren në vendin e origjinës dhe më pas kthehet në universitetin holandez për të shkruar dhe mbrojtur disertacionin.

Bursa për PHD në Shkenca Sociale, Matematikë, Statistikë apo Ekonomik

Qendra Ndëruniversitare për Shkenca Sociale, Teori dhe Metodologji (ICS) është një shkollë e njohur për kërkim dhe trajnim universitar, që ndodhet në Holandë në Universitetet e Groningen, Utrecht dhe Nijmegen.

ICS ofron bursa PHD me financim të plotë për disa projekte të kandidatëve të shkëlqyer që janë diplomuar së fundmi në një nga shkencat sociale. Të diplomuarit në Matematikë, Statistikë apo Ekonomik janë gjithashtu të ftuar të aplikojnë.

Studentët PHD do të emërohen për një periudhë të plotë katër vjeçare gjatë të cilës të diplomuarit do të punojnë për një projekt të veçantë, që do të çojë në disertacionin për doktoraturë. Bujare mbulojnë regjistrimin, shpenzime për kërkimin dhe jetesën. Paga arrin përafërsisht €2.000,00 –me gjithë taksat në vitin e parë, dhe shkon përafërsisht në €2.558,00 me gjithë taksat në vitin e katërt. Nuk ka tarifa regjistrimi.

Më shumë informacion për ICS dhe pozicionet e lira për PHD mund të gjenden në faqen e ICS: <http://www.ics-graduateschool.nl>.

c) Lista e universiteteve dhe kolegjeve kryesore

Universiteti i Amsterdemit (www.uva.nl)

Universiteti është një universitet kërkimi gjithëpërfshirës që ndodhet në zemër të qytetit të Amsterdemit. Ka shtatë fakultete, Shkencat Humane, Sociale, Ekonomik, Juridik, Shkencë, Mjekësi dhe Stomatologji. Ka një program të rëndësishëm të internacionalizuar dhe ofron 85 Programe Masteri në Anglisht si dhe disa kurse gjuhe në holandisht dhe anglisht.

Qendra Akademike Mjekësore (<http://www.amc.uva.nl/index.cfm?sid=818>)

AMC është spital universitar degë me Universitetin e Amsterdemit. Është një nga spitalet më të mëdha dhe kryesore të Holandës, që ndodhet në Bijlmer në pjesën me juglindore të qytetit.

Universiteti i Groningen-it (www.rug.nl)

Universiteti i Groningenit, që ndodhet në qytetin Groningen, u themelua në 1614. Është universiteti i dytë më i vjetër dhe i treti më i madh në Holandë.

Universiteti i Mastrohit (www.unimaas.nl)

Universiteti i Mastrohit i themeluar në 1976 është universiteti i dytë më i ri në Holandë dhe renditet kështu mes universiteteve më të mira në Holandë për arsimit.

Universiteti i Mastrohit ka rreth 11500 studentë dhe 3000 punonjës, 30% e të cilëve janë studentë të huaj. Universiteti njihet për metodën e të mësuarit bazuar në zgjidhjen e problemeve si një mënyrë e re mësimdhënieve. Rreth gjysma e programeve universitare ofrohen plotësisht në anglisht, ndërsa gjysma jepet në holandisht. Shumica e programeve pasuniversitare janë në Anglisht.

Universiteti i Utrechit (www.uu.nl)

Është një nga universitetet më të vjetra në Holandë dhe një nga më të mëdhenjtë në Europë. Është cilësuar si universiteti i shtatë më i mirë në Europë në Renditjen Akademike të Universiteteve në Botë.

Universiteti Fontys i Shkencave të Aplikuara

<http://www.fontys.nl>

d) Programe për studentë të huaj

Studime në Holandë

www.studyin.nl

Jep këshilla për të studiuar në Holandë.

Studimi në Europë

www.studyinurope.hobsons.com

Përfshin profile të sistemeve arsimore dhe mundësi studimi nëpër Europë.

Programi Holandez i Bursave

Informacion i përgjithshëm:

NFP për Azinë, Afrikën, Amerikën Latine dhe Europën Lindore, Nuffic, Holandën. Nën-programet e NFP janë: bursa për programe Master, bursa për kurse të shkurtra, bursa për studime PhD, kurse për përsëritës, dhe trajnime specifike. NFP është iniciuar dhe financiar plotësisht nga Ministria Holandeze e Punëve të Jashtme.

<http://www.studyin.nl/scholarships/>

<http://www.nuffic.nl/nfp>

5. Qëndrimi (i përkohshëm, i përhershëm, ripërtëritje/rinovim)

Me të mbërritur (nëse jeni shtetas jo i BE-së) duhet të regjistroheni në Policinë për të Huajt (Vreemdelingenpolitie) brenda tri ditëve punë. Policia për të Huajt mund të gjendet në Departamentin e Policisë të pothuajse çdo bashkie në Holandë, ata mbikëqyrin shtetasit e huaj në Holandë.

Dokumentet e nevojshme:

- Një pasaportë e vlefshme
- Një adresë në Holandë
- Vërtetim i fondeve të mjaftueshme për qëndrimin.

Policia vendos një pullë në pasaportë që shënon datën deri kur mund të qëndroni ligjërisht në Holandë (kohëzgjatja e vizës ose leje qëndrimi tre mujor). Policia ju jep një kartë që përcakton se mbajtësi është i ligjshëm në vend.

Policia për të Huajt, numri për të pyetur Policinë Kombëtare

Tel: 0900 8844

Për Leje qëndrimi të përkohshëm mund të aplikoni në Departamentin e Çështjeve Civile të bashkisë vendore. IND kontrollon që ju i plotësoni të gjitha kushtet dhe testet për tuberkuloz.

Aplikimet për leje qëndrimi (VVR) duhet të bëhen gjithashtu në autoritetin bashkiak lokal. Dokumente të nevojshme varen nga qëllimi i qëndrimit; megjithatë një fotografi e kohëve të fundit pasaportë dhe një pasaportë e vlefshme janë gjithmonë të nevojshme. Autoriteti bashkiak më pas do të vendosë një ngjithëse në pasaportë për të vërtetuar që jeni rezidentë të ligjshëm në Holandë ndërsa prisni vendimin e IND (kjo mund të zgjasë deri në gjashtë muaj).

Në përgjithësi, leja e qëndrimit nxirret për një vit dhe është e rinovueshme çdo vit nëse vazhdohet të plotësohen kushtet.

Shtyrja e një leje qëndrimi

Pas vitit të parë është e mundur të aplikoni për shtyrjen e lejes së qëndrimit. Kjo duhet të bëhet përpara se të mbarojë. IND zakonisht dërgon një letër tre muaj përpara mbarimit të lejes me një formular aplikimi. Nëse leja shtyhet dhe për sa kohë kjo do të varet nga situata juaj, periudha maksimale për të cilën mund të shtyhet leja është pesë vjet.

Ndryshimi i lejes së qëndrimit

Është e nevojshme të aplikoni për një leje qëndrimi nëse:

- Ndryshon qëllimi ose arsyeja e qëndrimit,
- Ndryshon gjendja juaj personale,
- Ndryshon gjendja e sponsorit, për shembull ndryshon punëdhënësi ose nëse ju keni zgjedhur të qëndroni me dikë tjetër

Leje qëndrimi për qëndrim të vazhdueshëm

Një person që qëndron në Holandë me një leje qëndrimi për një periudhë të caktuar mund të ketë të drejtën për një leje për qëndrim të vazhdueshëm. Për të aplikuar për një leje të tillë ju duhet:

- Të jeni të martuar ose në partneriteti të regjistruar për më shumë se tre vjet,
- Të jeni të martuar ose në partneriteti të regjistruar dhe bashkëshorti/bashkëshortja juaj vdes,
- Të jeni të martuar ose në partneriteti të regjistruar dhe të keni arsye me natyrë humanitare,

- Të jeni i mitur dhe të keni pasur leje qëndrimi për më shumë se një vit që ju ka lejuar të qëndroni me një prind
- Të jeni i mitur dhe prindi tuaj apo prindi adoptues/birësues të ketë vdekur,
- Te jeni 18 vjeç e lart, e të keni qëndruar me një prind të tre vjet ose më shumë,
- Te jeni 18 vjeç e lart dhe prindi juaj të ketë vdekur
- Të jeni viktimë e dhunës shtëpiake
- Të jeni prind që ka qëndruar me fëmijën më shumë se tre vjet,
- Të keni një leje qëndrimi si një shtetas i huaj nën-moshë i vetmuar për më shumë se tre vjet,
- Të keni një leje qëndrimi për më shumë se tre vjet për shkak të pamundësisë për t'u larguar nga Holanda për rrethana jashtë kontrollit tuaj,
- Të keni pasur një leje qëndrimi për më shumë se tre vjet për arsye shëndetësore dhe trajtimi i mëtejshëm është i nevojshëm për të paktën një vit.

6. Procedura e azilit

Nëse doni të aplikoni për azil në Holandë duhet të shkoni në një qendër aplikimi (AC). Dorëzoni aplikimin në këtë qendër dhe aty do të bëhet vlerësimi i parë i aplikimit. Me aplikimin për azil ju i kërkon qeverisë holandeze t'ju japë një leje qëndrimi. Shërbimi i Imigracionit dhe Natyralizimit (IND) do të hetojë nëse mund të pranoheni apo jo. Pasi të jeni regjistruar do t'ju çojnë në një qendër pritjeje të përkohshme. Do të ktheheni në qendrën e aplikimit për intervista.

Nëse IND ka miratuar aplikimin tuaj për azil, do të merrni një leje qëndrimit të përkohshme për azil dhe do të lejoheni të qëndroni në Holandë gjatë kësaj kohe. Nëse është refuzuar aplikimi do t'ju kërkohet të largoheni nga Holanda. Vendimi që do të merrni do të konfirmojë një afat kohor brenda të cilit duhet të largoheni nga Holanda. Ju jeni përgjegjës për të organizuar largimin. Nëse nuk largoheni në mënyrë të pavarur brenda kësaj periudhe të përcaktuar, do t'ju largojnë ose do t'ju kërkojnë të largoheni me mbikëqyrje. Nëse kërkon ndihmë për riatdhesimin, mund të kontaktoni Organizatën Ndërkombëtare për Migracion (IOM)

Nëse ju jepet leje qëndrimi për azil:

- duhet të merrni pjesë në një kurs për integrim qytetar
- do të lejoheni të punoni
- do të keni të drejtë për bashkim familjar me bashkëshortin/bashkëshorten, partnerin ose fëmijën
- do të jeni të drejtë për akomodim
- do të mund të aplikoni për pasaportë për refugjat në bashkinë ku jetoni
- do të mund të aplikoni për shtetësi holandeze nëse keni qëndruar në Holandë për minimumi 5 vjet në bazë të lejes së vlefshme të qëndrimit dhe tani keni leje qëndrimi të përhershëm ose tjetër leje qëndrimi jo të përkohshme
- do të keni të drejtë për shkollim
- mund të keni të drejtë për ndihmë financiare për studentë

Më shumë informacion për azilin: <http://www.ind.nl>

7. Bashkimi familjar

Nëse dëshironi të qëndroni në Holandë për qëllim të bashkimit familjar do të duhet të plotësoni kërkesat e mëposhtme:

Bashkëshorti/ja:

- Jeni i martuar me dikë ose jeni partner (i regjistruar) i dikujt në Holandë
- Jeni të dy mbi 18 vjeç
- Burri ose gruaja ose partneri (i regjistruar) ka mjete të mjaftueshme afatgjata financiare
- Keni marrë dhe keni kaluar provimin për integrim qytetar ose ju është bërë një përgjashtim

Fëmijë i mitur:

- Je fëmija biologjik ose i ligjshëm i dikujt që është me qëndrim në Holandë
- Do të jetoni me prindin ose përfaqësuesin ligjor në Holandë

- Prindi juaj ka mjete të mjaftueshme financiare
- Nëse jeni 16 vjeç ose më shumë: Keni marrë dhe keni kaluar provimin për integrim qytetar ose ju është bërë një përjashtim

Fëmijët e rritur mund të aplikojnë gjithashtu nëse provojnë që, përveç kërkesave të mësipërme, nëse mbeten në vendin e origjinës do të hasin vështirësi të paarsyeshme. Kjo do të thotë që, nëse lihen në vendin e tyre të origjinës, do të vihen në një situatë jashtëzakonisht stresuese.

Një prind:

- Jeni 65 vjeç ose më shumë
- Jeni beqar
- Pothuajse të gjithë fëmijët janë me qëndrim të ligjshëm në Holandë
- Në vendin e origjinës nuk ka asnjë fëmijë që t'ju mbajë
- Ndërmjet tyre, fëmijët që jetojnë në Holandë kanë mjete të mjaftueshme financiare për t'ju mbajtur juve dhe familjen e tyre

Anëtarët e familjes do të duhet të aplikojnë për MVV dhe leje qëndrimi të përkohshëm.

8. Sistemi i kujdesit shëndetësor

Sigurimi shëndetësor është i detyrueshëm kur jetoni dhe/ose punoni në Holandë. Ekziston një sigurim bazë i përgjithshëm që mbulohet nga siguruesit privatë për shpenzime mjekësore. Ata që kanë të ardhura të pakta kanë të drejtë për "ndihmën e kujdesit" (*zorgtoeslag*), deri në një shumë maksimale prej 330 euro në vit.

Mbulimi është vetëm bazë. Prandaj rekomandohet të merrni të ashtuquajturin "mbulim shtesë" për koston e:

- Kujdesit të rregullt dentar;
- Fizioterapisë dhe
- Trajtimeve të tjera afatgjata.

Sigurimi bazë dhe sigurimi shtesë nuk duhet të bëhen në të njëjtën kompani sigurimi. Kur jetoni në Holandë, duhet të regjistroheni tek një Doktor i Përgjithshëm (*huisarts*). Mund të zgjidhni GP tuaj, por zgjedhja juaj është e kufizuar në zonën ku jetoni. Shumica e GP kanë orar konsultimi në kohë të caktuar për të cilin duhet të lini një takim paraprakisht. Nëse konsiderohet i nevojshëm trajtimi nga një specialist, GP do t'ju drejtojë për një spital ose mjek specialist. Ndiha mjekësore nga një spital ose specialist nuk do të jepet pa orientimin nga një GP! Të vetmet përjashtime janë:

- Kujdesi dentar;
- Trajtime nga departament të spitaleve të mëdha për raste aksidenti dhe urgjencash.

9. Sistemi i sigurimeve shoqërore

Rregullimet e sigurimeve shoqërore; BBZ (Bijstands Besluit Zelfstandigen)

Sistemi holandez i sigurimeve shoqërore është një nga më gjithëpërfshirësit në BE. Sapo të filloni punë në Holandë do të filloni të paguani automatikisht në sistemin holandez të sigurimeve shoqërore. Shumica e kontributeve të sigurimeve shoqërore zbriten automatikisht nga paga juaj. Në rast të të ashtuquajturit sigurim punëmarrësi, dhe ju dhe punëdhënësi do të paguajnë kontribute.

Nëse jeni rezidenti i ligjshëm në Holandë por nuk keni mjete financiare për të mbajtur veten për shkak të:

- Paaftësisë afatgjatë;
- papunësisë.

mund të kërkonit të përfitoni nga Shteti holandez (Ministria e Punëve Sociale)

E drejta juaj për të përfituar si rezultat i papunësisë të pavullnetshëm konsiderohet si masë e përkohshme kalimtare. Ju takon juve të bëni të gjitha përpjekjet për të gjetur sa më shpejt një punë tjetër. Në këtë drejtim, çdo punë konsiderohet e përshtatshme. Agjencia e Sigurimit të Punëmarrësve (Uitvoeringsinstituut Werknemersverzekeringen – UWV) ofron këshillim me telefon për punëkërkesit që qëndrojnë në Holandë dhe mund të marrin në numrin: 0031 113750350.

10. Strehimi (faqe interneti, kushte të veçanta për të huajt kur vlejnjë ...)

46% e shtëpive në Holandë janë me qira. Edhe më karakteristike për Holandës është pjesa shumë e madhe e shtëpive sociale me qira që tani përfaqësojnë rreth 35% (ose rreth 2.4 milion banesa) të të gjithë stokut dhe 75% e atyre që janë me qira. Asnjë vend në BE ka një përqindje kaq të lartë të banesave sociale me qira. Këto kryesisht janë në pronësi dhe menaxhohen nga shoqatat e strehimit.

Qiradhënia rregullohet akoma përgjithësisht: sot akoma 95% e qiradhënies funksionon sipas një kuadri të veçantë rregullues. Për shkak të numrit të vogël të akomodimeve për qira do të viheni në një listë pritjeje. Mundësia e një rezultati të shpejtë rritet ose pakësohet në varësi të çmimit për të cilin doni të konsideroheni. Këshillohet të mbani rregullisht kontakte me korporatën e strehimit ku jeni regjistruar. Ju lejohet të refuzoni akomodimin që ju ofrohet vetëm në rrethana të kufizuara. Nëse lidhni një marrëveshje qiraje zakonisht do t'ju kërkohet një depozitë (p.sh një shumë ekuivalente me qiranë e një muaji, që ju kthehet në fund të kohës së qiramarrjes). Për prishjen e marrëveshjes duhet të njoftoni të paktën një muaj më përpara.

Mund të kontrolloni shumën e qirasë duke kontaktuar të ashtuquajturin "Komision i Qirave". Vizitoni faqen e internetit të Ministrisë së Strehimit, Planifikimit Hapësinor dhe Mjedisit (VROM) (<http://www.vrom.nl/pagina.html?id=8061>)

Subvencion qiraje

Nëse shuma e qirasë është ndërmjet 162.45 Euro dhe 541.36 Euro në muaj, ka mundësi të keni të drejtë për një subvencion qiraje. Kjo varet nga të ardhurat tuaja, asetet, mosha dhe struktura familjare.

Blerjet

Shumë holandezë blejnë shtëpi. Lehtësimi tatimor për pagesat e interesave të kredisë e bën përfitues blerjen e një shtëpie. Për të blerë shtëpi mund të vizitoni një agjent të pasurive të paluajtshme ose të vizitoni faqet e internetit në të cilat agjencitë tregojnë shtëpitë që janë në shitje. Agjencitë kërkojnë një përqindje mbi çmimin e shitjes. Kini parasysh që shumica e çmimeve që janë caktuar nuk përfshijnë këto kosto si tarifën e agjentit dhe të transfertës. Këto njihen si "kosto të blerësit". Megjithatë, me shtëpitë e reja çmimet e kuotuar normalisht i përfshijnë. Akti i blerjes hartohet nga një noter që do të ketë dhe ai një tarifë të vetën. Nëse ka hipotekë, akti për këtë do të bëhet përsëri nga një noter. Shoqata "Eigen Huis" mund të ofrojë këshilla praktike dhe ndihmë personale përpara dhe gjatë blerjes.

Refugjatët

Bazuar në Aktin Holandez të Strehimit (Holandisht: "Huisvestingswet (Hvw)"), çdo gjashtë muaj bashkitë detyrohen të strehojnë si duhet ose të akomodojnë një numër të caktuar refugjatësh dhe të raportojnë këto arritje në këtë drejtim. Refugjatët i përkasin grupeve të synuara për shoqatat e strehimit. Nuk ka një politikë specifike të qeverisë që synon të marrë parasysh të shkuarën e imigrantëve që nuk janë nga perëndimi sepse modeli i tyre i jetesës është pak a shumë i ngjashëm me atë të popullsisë vendase.

Më shumë informacion për strehimin mund të gjeni në <http://international.vrom.nl/pagina.html?id=7557>

Një listë e faqeve për të gjetur strehim mund të shihet në: <http://international.vrom.nl/pagina.html?id=10951>

11. Njohja e diplomave (kushtet, organet e rëndësishme profesionale)

Nuffic është një nga qendrat më të mëdha dhe të famshme të njohurisë në Europë në fushën e njohjes ndërkombëtare të diplomave. Ata nëpërmjet shërbimeve të vlerësimit të kredencialeve informojnë organizatat holandeze dhe organizatat ndërkombëtare.

Nuffic është krijuar nga Ministria Holandeze e Arsimit, Kulturës dhe Shkencës si qendër informacioni për njohjet për dy rrjetet europiane: NARIC dhe ENIC. Ata kanë shumë vite përvojë në këtë fushë dhe punojnë për të gjitha

organizata që kanë të bëjnë me diploma të huaja në punën e tyre siç janë universitetet, institucione të tjera të arsimit të lartë, kompanitë dhe ministritë. Nuffic ofron shërbimet dhe produktet e mëposhtme në fushën e vlerësimit të kredencialeve:

- Vlerësimi i diplomave të huaja (lëvizshmëria hyrëse)
- Kurse të vlerësimit të kredencialeve
- Shërbime informacioni

Kontrolloni: www.idw.nl

dhe <http://www.nuffic.nl/international-organizations/services/professional-recognition>

12. Shërbimet mbështetëse të ofruara për migrantët

Shërbimi i Imigracionit dhe Natyralizimit (IND)

Immigratie- en Naturalisatiedienst

Afdeling Voorlichting

Postbus 3211

2280 GE Rijswijk

0900-1234561

+31 20 8893045 (nga jashtë vendit)

www.ind.nl

Organizata Ndërkombëtare për Migracionin (IOM)

Misioni në Holandë

P.O. BOX 10796

2501 ht the Hague

Tel: + 31 70 318 15 00

Fax: + 31 70 338 54

E-mail: Missionthehague@iom.int

Faqe interneti: www.iom-nederland.nl

Linja e ndihmës për personat e humbur

Për të gjitha pyetjet tuaja ose nevojën e mbështetjes telefononi në numrin pa pagesë 0800 - VERMIST / 0800 83 76 468 nëse telefononi në Holandë (24 orë në ditë, 7 ditë) ose (+) 31 70 44 55 618 nëse telefononi nga jashtë.

Puna Skllavëruese në Holandë - <http://www.blinn.nl/?c=home&lang=gb>

Programi synon të ofrojë në mënyrë të strukturuar të ardhme më të mirë për personat e trafikuar. Bazuar në nevojat e tyre, interesat dhe aftësitë, hartohet një plan mbështetjeje.

BLinN - Humanitas / Novib

Adresa: Weteringschans 259

Adresa: Postbus 71

1000 AB Amsterdam

info@blinn.nl

Tel 020 523 11 00

Fax 020 622 73 67

Fondacioni i Besimtarëve kundër Trafikimit të Grave (SRTV) http://www.srtv.info/engels/srtv/index_uk.html

Fondacioni Holandez i Fesë kundër Trafikimit të Grave

Sint Janssingel 92

5211 DA 's-Hertogenbosch

The Netherlands

Tel : +31- 73 - 615 44 44

Fax: +31- 73 - 615 44 49

E-mail: srtv@srtv.info
Faqe interneti: www.srtv.info

Mbështetje për Migrantët pa dokumente
Platform Migranten Zonder Verblijfsvergunning PMZV

Utrecht Street Kanaalstraat 243
NL-3531 CJ
Tel 31-30-2990222
Fax 31-30-2990223
E-mail info@stichtinglos.nl

Nederlands Migratie Instituut – Instituti Holandez i Migracionit NMI

Instituti Holandez i Migracionit (NMI) ofron shërbime ku mund të përfshihen lehtësisht migrantët që konsiderojnë kthimin në vendin e origjinës. Të kthyerve të ardhshëm u jepet informacion objektiv dhe i rëndësishëm, këshillim në procesin vendimmarrës dhe mbështeten për përmbushjen e kërkesave administrative që lidhje me Aktin e Riatdhesimit Holandez www.nmigratie.nl

Utrecht Street Postbus 19215 - Catharijnesingel 50 NL-3501 DE
Tel 31-30-2342936
Fax 31-30-2304932
E-mail nmi@nmigratie.nl

13. Marrja e shtetësisë /kombësisë (kërkesat, kush mund të aplikojë etj)

NËPËRMJET LINDJES: Lindja brenda territorit të Holandës nuk ju jep automatikisht shtetësinë.

NËPËRMJET PREJARDHJES: Fëmijë i lindur nga martesë, ku një prind është shtetas holandez. Fëmijë i adoptuar, kur një prind është shtetas holandez dhe adoptimi është në përputhje me legjislacionin holandez. Fëmijë i lindur jashtë martesë që ka mamanë shtetase holandeze. Fëmijë i lindur jashtë martesë që ka mamanë të huaj dhe babain shtetas holandez – shtetësia nuk jepet derisa fëmija të ligjërohet dhe të njihet nga babai holandez.

NËPËRMJET NATYRALIZIMIT: shtetësia holandeze mund të kërkohet pas plotësimit të kushteve të mëposhtme: qëndrimi i vazhdueshëm në vend për të paktën pesë vjet dhe aftësia për të folur holandisht. Bashkëshortë të huaj të shtetasve holandezë mund të aplikojnë për shtetësi pas tre vite martesë nëse mund të flasin holandisht.

SHTETËSIA E DYFISHTË: NUK NJIHET. Përjashtime: Fëmijë holandez i lindur jashtë që merr shtetësinë e vendit të lindjes. Pasi arrin moshën madhore, personi mund të zgjedhë kë shtetësi të mbajë. Personit që merr në mënyrë të pavullnetshme një shtetësi tjetër, nuk mund t'i kërkohet të heqë dorë nga shtetësia holandeze.

Çështjet në lidhje me shtetësinë e dyfishtë dhe marrjen në mënyrë të pavullnetshme të një shtetësie të huaj nuk janë tërësisht të qarta në gjykata holandeze. Në raste kur statusi i shtetësisë së dyfishtë holandeze është i paqartë, kontaktoni konsullatën për sqarime.

14. Kontakte dhe informacion tjetër i nevojshëm

Ambasada e **Shqipërisë** në Holandë
Anna Paulownastraat 109 B
2518 BD, The Hague
Tel: 31 70 4272101, +31 70 3632021
Fax: 31 70 4272083
Email: embassy.hague@mfa.gov.al

Ambasada e **Bosnjë Hercegovinës** në Holandë
2495 AL, Bezuidenhoutseweg 223
The Hague
Tel: 31 70 35 88 505

Fax: 31 70 35 84 367
Faqe interneti: <http://www.xs4all.nl/~bih/>
Email: ejerkic@euronet.nl

Ambasada e **Kroacisë** në Holandë
Amalstraat 16
NL-2514 JC, The Hague
Tel: (+31-70) 362-3638, 363-2942
Fax: (+31-70) 362-3195, 392-7823
Faqe interneti: <http://nl.mvp.hr>
Email: croemb.haag@mvp.hr

Ambasada e **Republikës së Maqedonisë** në Holandë
Laan van Meerdevoort 50 - C
2517 AM The Hague
Tel: 31 70 427 44 64 or 31 70 427 44 65
Fax: 31 70 427 44 69

Ambasada e **Republikës së Serbisë**
Groot Hertoginnelaan 30
2517EG The Hague
Tel. (070) 3636800, 3632397
Fax. (070) 3602421
e-mail: yuambanl@bart.nl

Ministria e Shëndetësisë, Mirëqenies dhe Sporteve - Ministerie van Volksgezondheid, Welzijn en Sport
www.minvws.nl

Ministria e Arsimit, Kulturës dhe Shkencës - Ministerie van Onderwijs, Cultuur, en Wetenschappen
www.minocw.n

|
Ministria e Mbrojtjes - Ministerie van Defensie
www.mindef.nl

Ministria e Marrëdhënieve të Brendshme dhe të Mbretërisë - Ministerie van Binnenlandse Zaken en Koninkrijksrelaties
www.minbzk.nl

Ministria e Drejtësisë - Ministerie van Justitie (in Dutch)
www.justitie.nl

Ministria e Strehimit, Planifikimit Hapësinor dhe Mjedisit - Ministerie van Volkshuisvesting, Ruimtelijke Ordening en Milieu
www.minvrom.nl

Ministria e Punëve të Jashtme - Ministerie van Buitenlandse Zaken
www.bz.minbuza.nl
www.mfa.nl